

Nr ____ Prot

Durrës, më ___/___/___

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Për trajnimin dhe vlerësimin (në konkurs) të studentëve

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet sot më datën ___/___/___/ në Fakultetin e Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP) ndërmjet FASTIP-it me autoritet Drejtues, Dekanin, z. Vladimir Muka dhe titullarit të Kompanisë trajnuese _____ .

Neni 1. OBJEKTI I MARRËVESHJES

- Kompania trajnuese merr përsipër të organizojë konkursin dhe vlerësimin në datat e caktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe të plotësojë Deklaratën bashkangjitur.
- Kompania trajnuese merr përsipër të trajnojë gjatë kohëzgjatjes së studimeve të ciklit të parë (tre vjet), studentin _____.
- Kompania trajnuese merr përsipër të financojë studimet teorike të studentit në shumën e përcaktuar me Vendim të Këshillit të Fakultetit të FASTIP-it.

Neni 2. KOHA NORMALE E TRAJNIMIT

Koha vjetore e trajnimit do të jetë 24 javë në vit. Periudha e kryerjes së trajnimit përcaktohet në grafikun e kalendarit mësimor të hartuar nga FASTIP-i.

Neni 3. PROCEDURA PËR ZGJIDHJEN E MARRËVESHJES

Palët nuk mund të zgjidhin marrëveshjen e bashkëpunimit në mënyrë të njëanshme.

Marrëveshja e bashkëpunimit është e vlefshme për sa kohë që palët nuk kanë kërkuar zgjidhjen e saj me mirëkuptim, të njoftuar me shkrim 30 ditë përpara zgjidhjes.

Mosmarrëveshjet që nuk zgjidhen me mirëkuptim, i kalojnë për shqyrtim Gjykatës së Rrethit Durrës.

Neni 4. RESPEKTIMI I DETYRIMEVE

Palët duhet të zbatojnë me përpikmëri pikat e kësaj marrëveshjeje.

Kjo kontratë përpilohet në 3(tre) kopje nga të cilat dy i mban FASTIP-i dhe një Kompania trajnuese. Çdo ndryshim i dispozitave të kësaj kontrate me pasoja juridike duhet të përfundohet me shkrim nga palët.

Kompania Trajnuese

Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën

Titullari i Kompanisë

DEKANI

Doc.Vladimir Muka

Deklaratë

e përbashkët

E hartuar midis kompanisë _____
me Nr. NIPT-i _____
përfaqësuar nga z. _____
dhe maturantit _____

Sot më datë ____/____/_____
në mjediset e kompanisë _____
u zhvillua konkursi (Test në gjuhën angleze + test punësimi).

Maturanti _____ në përfundim të konkursit u
vlerësua me _____ pikë.

Kompania merr përsipër të aktivizojë dhe trajnojë studentin në procese të
ndryshme pune në kompani si dhe të financojë studimet e maturantit në masën e
përcaktuar nga Këshilli i Fakultetit të FASTIP-it për tre vite studimi.

Maturanti merr përsipër të respektojë të gjitha rregullat e përcaktuara nga
kompania.

Për kompaninë

(emër, mbiemër, firmë, vulë)

Maturanti

(emër, mbiemër, firmë,)

Shënime:

- 1) Maturanti kualifikohet nëse merr nga 1 pikë deri 100 pikë.
- 2) Deklarata dorëzohet në protokollin e FASTIP-it brenda afateve të përcaktuara.